

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	06/2021
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	16. 12. 2021 ora 10:00

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive "KKS" – Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS).

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Xhevahir Hasanaj - përfaqësues i FSK-së
Halim Shehu - Komuniteti Islam
Mikel Sopi - Komuniteti katolik
Enver Shabani - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë
Astrit Bytyqi - Përfaqësues i QJQ-së
Adem Dergut i- Kryetr i KPAK-së
Astrit Vrella – mediat lokale
Fetije Bytyqi - Përfaqësuese e KLSP-së.
Remzi Bajselmani - Drejtor i Arsimit
Habibe Bytyqi i - Zyrtare për barazi gjinore
Xheladin Sadikaj - Përfaqësues i zyrës KKK-së
Hanife Bytyqi - Përfaqësuese e KPAK-së
Zekë Berisha - Përfaqësues i KRE-ja
Shkëndije Shabanaj - Kryesues i KK-së dhe përfaqësuesi KA-li
Shaqir Palush i -Komuniteti i biznesit
Nazim Shabanaj - Përfaqësuese e Egjiptasve

Në takim munguan:

REND DITE

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2.Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e komunës;**
- 3.Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;**
- 4.Komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarë nga ana e policisë në komunitet;**
- 5.Përgaditja e planit të veprimit për KKSBB për vitin 2022;**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj.

Kryetari - përshëndet të pranishmit.I njofton me rendin e ditës.

Avni Bytyqi - kemi kërkesë nga këshilli drejtues i shkollës në bashkëpunim me këshillin e nxënësve të gjimnazit “Jeta e re”.Kërkesa e tyre është që të mbahet një ligjërrata për çështjen e mobilizimit të rinisë për parandalimin e hershëm të dukurive negative.

Kryetari - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Aprovohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;

Kryetari - pasi kjo pikë ka të bëjë me sigurinë në territorin e Komunës, ia jep fjalën komandantit të policisë z.Afrim Sylaj.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit,dhe raporton për 11 mujorin e vitit 2021.Kemi 547 vepra.Raste të dhunës në familje 45 raste 2020 dhe 65 raste 2021, falsifikimi i parasë 6 raste 2020 dhe 20 raste 2021, vjedhje 84 raste,vjedhje me tentativë 17 raste, asgjësim i pasurisë 73 raste, zjarrëdhënie rreth 50% më shumë raste, mashtrime rreth 46 % raste më pak, aksidente trafiku një rast me fatalitet këtë vit,aksidente trafiku me dëme materiale 209 raste,rreth 74 % rritje të realizimit të urdhërave të gjykatës,tiketa të shqiptuara 6.5 % më shumë,tiketa Covid 4588. Nga 77 plane operative që kanë qenë,janë realizuar 266 plane operative nga policia në Suharekë.Patrullime me vetura 2275,pika të kontrollit 2% më shumë këtë vit, armë të konfiskuara 26, 385 monicione të konfiskuara ose 28 % më shumë. Vizita,kontakte,patrullime në shkolla, 249 vizita.102 kontakte me gjykata, 89 takime me zyrtarë të Kuvendit komunal,62

kontakte me QPS,38 takime me përfaqësues të bizneseve,105 takime me përfaqësues të klubeve sportive . Ne do të vazhdojmë me ofrimin e sigurisë,të jemi sa më pranë qytetarëve.

Xheladin Sadikaj - përshëndet të pranishmit.Nga këto takime të KKSBB-së shumë herë kemi nxerr rekomandime mbi sigurinë dhe sidomos prezencën e policisë para shkollës në kohën kur lëshohen nxënësat.Problemet janë në rritje,e sidomos në shkollën teknike nga grupe kriminale të nxënësëve që nuk din shkrim- lexim,që vet drejtori i shkollës ka raportu.A mos ndoshta reagojmë pasi ndodh më e keqja,pasi kemi një nxënës të vrarë?A mos kemi harruar trekëndëshin e shkollës kujdestar-shkollë-polici.Me datë 10 të këtij muaji,ka ndodh një rast i rrahjes së një nxënësi të shkëlqyer në këtë shkollë në mënyrën më mizore,nga një grup nxënësish kriminal.Policia është lajmëruar nga kalimtari i rastit dhe jo nga organet shkollore.Prezenca e policisë ka qenë e vonuar dhe angazhimi ka qenë zero rreth rastit. Rekomandime nxjerrim, por prezencë të policisë nuk ka.

Kryetari - trekëndëshi është prind-fëmijë-kujdestar.Çdo prind duhet të dijë për fëmijën e tij,kur shkon në shkollë dhe kur kthehet.Dhe çfarë do të bëjë drejtori me 800 nxënës.

Xheladin Sadikaj - duhet të merret kujdestari,pedagogu sepse prindi nuk është në shkollë.Kemi të bëjmë me një nxënës shembullor dhe jo problematikë.

Afrim Sylaj - tash po dëgjoj për këtë rast,dhe ju si person zyrtar duhet me ardh në stacionin policor,me raportu dhe me zgjidh këtë çështje.

Kryetari - komandanti i policisë nuk merr urdhëra nga Kryetari i Komunës.Ky këshill jep rekomandime dhe ne ia dërgojmë policisë.

Avni Bytyqi - KKSBB është organ rekomandues.Të gjitha rekomandimet që kanë dal nga ky këshill janë zbatuar.Sa për rastin të dal një rekomandim nga ky këshill,që të vazhdohet me patrullim edhe te shkolla ku kemi probleme apo ku vërehen dukuritë negative që janë evidente.

Afrim Sylaj - unë nuk kam njohuri për këtë rat,por menjëherë do të mirren masat për zgjidhjen e këtij problemi.

Adem Dërguti - përshëndet të pranishmit.Udhëheqja e klasës duhet të lajmëroj kujdestarin,e pastaj kujdestari drejtorin dhe prej drejtorit vie deri te policia,nëse është ndonjë problem i madh.Flitet se bartin thika,boksa.Duhet ti kontrollojnë nxënësit edhe në autobus dhe në shkollë mënyrë që të mos kemi probleme.

Kryetari - Por për me marrë një vendim për bastisjen e autobusëve,duhet të merret vendim nga organet,dhe është mirë me gjet metodën,por jo si të dojmë.Nëse ne,secili i kryen detyrat e veta punët shkojnë me mirë.Ne jemi mundu mi zbatu udhëzimet administrative,udhëzimet me baza fetare,ligjore,bashkëpunimin me gjininë femërore.

Rekomandim: bashkëpunimi i qytetarëve me policinë lidhur me raportimin e rasteve që rrezikojnë sigurinë e përgjithshme të qytetarëve.

Kryetari - e hedh në votim.

Aprovohet

Remzi Bajselmani - kisha kërku që deklaratimet publike,veçanërisht të zyrtarëve publik me qenë më të matura,sepse po keqinterpretohen.

Pika 3. Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;

Kryetari - është mirë të caktohen lokacionet për mjetet piroteknike me datë të caktuar nën përcjelljen e policisë dy ose tre ditë para festave.

Rekomandim: caktohet lokacioni te tregu javor për shitjen e mjeteve piroteknike sipas udhëzimit administrativ nga data 25 – 2 janar.

Kryetari - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 4. Komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarë nga ana e policisë në komunitet;

Nënkryetarja - ia jep fjalën zyrtares për komunitete.

Fetije Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Ne kemi kontakt në qytet dhe në fshatra.Problemi më i madh te qytetarët në qytet dhe në fshatra është nga qent endacak.

Rasti që u tha për përleshjen në shkollën teknike,ne kemi dalë menjëherë me patrullë,por nuk ka pas asnjë përleshje,kemi pyet edhe kalimtarë të rastit,por asgjë.

Afrim Sylaj - policia e Kosovës pa bashkëpunim me qytetar nuk mund të funksionojë.Mbi 75 raste në vitin 2021 që kemi pas,të gjitha janë zbulu falë bashkëpunimit të qytetarëve.Te rastet individuale,ne do të mirremi me çdo ankesë dhe do ta rishqyrtojmë.Ne do ta rrisim bashkëpunimin me qytetarë,do të jemi afër qytetarëve.Kemi planifikime për vitin 2022 dhe jemi duke mbajtur takime me të gjitha institucionet me qëllim që të ofrojmë siguri.

Habibe Bytyqi - komandant,the që dje ke pas takim me drejtorat e shkollave.A u potencu ky rasti konkret?

Afrim Sylaj - jo nuk është potencu.

Remzi Bajselmani - për shkollën në fjalë,aktualisht është më e sigurta në Komunë.Deri tani nuk kemi informatë sikurse që u tha.

Rekomandim: bashkëpunimi me qytetarë dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me akterët kryesor të fushës së sigurisë dhe problemet që janë për qytetarët.

Kryetari - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 5.Përgaditja e planit të veprimit për KKSB për vitin 2022;

Avni Bytyqi - ne e kemi hartu këtë plan me Kryetarin për vitin 2022,por do të ketë ndryshime për KKSB-në për vitet e ardhshme,përshkak se bëhet ndërrimi i Asamblesë.

Pika shtesë -

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor informon anëtarët e KKSB-së rreth kërkesës së gjimnazit,ku ata kanë kërku që të mbajnë ligjerata apo trajnime nga anëtarët e KKSB-së ,që ti trajtoni temat e çështjes së mobilizimit të të rinjëve për parandalimin e hershëm të dukurive negative dhe çështja e ligjëratave për mjetet e rrezikshme dhe mjetet piroteknike.

Rekomandim: Mobilizimi i të rinjëve për parandalim të hershëm të dukurive negative.
Për mjetet e rrezikshme të pashpërthyera pas luftës dhe mjetet piroteknike.

Afrim Sylaj - sa i përket ligjëratave,dërgone me shkrim dhe ne e shqyrtojmë menjëherë.

Avni Bytyqi - unë ia adresoj kërkesën gjimnazit, kërkoj planifikimin e orarit për në janar me data të caktuara dhe pastaj do ju adresoj kërkesën juvedhe FSK-së në mënyrë zyrtare.

Kryetari - e hedh në votim.

Aprovohet

Afrim Sylaj - te përzgjedhja e anëtarëve të KKS-së me pas konsideratë, me qenë njerëz kredibil.

Avni Bytyqi - disa pozita i përcakton udhëzimi.

Astrit Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Te kërkesa e gjimnazit, le të shkoj mesazhi në vendin e duhur.

Kryetari - falemnderon të gjithë për bashkëpunimin dhe angazhimin dhe i uron festat të gjithëve.

Takimi përfundoi: **10:55**

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj